

84 vjetori i shpalljes së Autoqefalisë



Nga historia e Kishës sonë –
84 vjetori i shpalljes së Autoqefalisë.

12 prill 1937 është ditë historike për Komunitetin Orthodhoks të vendit tonë, është dita e nënshkrimit të Tomosit të shpalljes dhe dhënies së Autoqefalisë nga Patriarkana e Konstandinopojës.

Nga ajo ditë e deri më sot Kisha Orthodhokse e Shqipërisë vazhdon jetën dhe veprimtarinë e saj shenjtëruese përkrah Kishave Orthodhokse Autoqefale.

“Më 12 prill 1937, në prani të një delegacioni nga Shqipëria, Patriarku Veniamin dhe Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike të Konstandinopojës nënshkruan Tomosin Patriarkal të njohjes së Autoqefalisë së Kishës Orthodhokse të Shqipërisë. Tomosi iu dorëzua Imzot Kristoforit duke e caktuar atë si Kryepiskop të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

<https://orthodoxalbania.org/.../80-vjet-me-pare-u-dha.../>

<https://orthodoxalbania.org/.../kisha.../historia-e-kishes/>

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)